

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

REZYME E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

**“VEPRIMTARIA LUFTARAKE NË ZONËN OPERATIVE TË
SHALËS 1998-1999”**

MENTOR: PROF. ASOC. DR.NURI BEXHETI

KANDIDATI: MIFTAR KURTI

PRISHTINË, 2022

REZYME

Zona Operative e Shalës (ZOSH) ishte njëra nga shtatë zonat operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Shtrihet në territorin e katër komunave: të Mitrovicës, të Vushtrrisë, të Leposaviqit dhe të Zubin Potokut. Kufizohet me Zonën Operative të Drenicës dhe Zonën Operative të Llapit. Përbëhet nga Brigada 141 “Mehë Uka”, Brigada 142 dhe nga njësi tjera vartëse. Komandant i saj ishte Rrahman Rama. Veprimet e saj luftarake kanë filluar në muajin qershor 1998 dhe kanë zgjatur deri në muajin qershor 1999. Luftimet më të ashpra në këtë zonë janë zhvilluar kryesisht në paralagjet e fshatrat e Komunave të Mitrovicës dhe të Vushtrrisë.

Disertacioni i doktoratës *“Veprimtaria luftarake në Zonën Operative të Shalës 1998-1999”* ka në fokus shtrirjen në kohë dhe hapësirë të veprimtarisë luftarake të kësaj zone operative. Disertacioni është strukturuar në gjashtë kapituj: *I. Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe rrethanat e krijimit të saj; II. Zona Operative e Shalës dhe struktura e saj; III. Veprimtaria luftarake e Nënzonës Operative të Shalës 1998; IV. Veprimtaria luftarake e Zonës Operative të Shalës 1999; V. Aspekte të strategjisë së UÇK-së; dhe VI. Zona Operative e Shalës në shtypin e kohës 1998-1999.*

Në *Kapitullin e parë* fillon faktikisht trajtimi i temës bosht. Koha dhe rrethanat e krijimit të UÇK-së, roli i saj në procesin e çlirimit të vendit, ballafaqimi me forcat e Ushtrisë Jugosllave (UJ), Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe forcave të tjera të sigurisë të Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ), përbëjnë shtyllat e këtij kapitulli. Natyrisht pa lënë anash edhe përpjekjet për strukturimin dhe ristrukturimin e UÇK-së, duke përfshirë këtu edhe Nënzonën Operative të Shalës (NZOSH) gjatë vitit 1998.

Në fokus të *Kapitullit të dytë* është shndërrimi i Nënzonës Operative të Shalës (NZOSH) në Zonë Operative të Shalës (ZOSH), strukturimi dhe ristrukturimi i saj; shtrirja, logjistika, shërbimi shëndetësor, komunikimi dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me strukturën organizative dhe funksionimin e saj nga nëntori 1998 e deri në qershor 1999.

Aksionet e shpejta, betejat e përgjakshme dhe luftimet e ashpra të NZOSH në periudhën kohore qershor-dhjetor 1998 kundër njërive elitare të UJ-së, të njërive policore të MPB-së, por edhe kundër mercenarëve nga vendet e ndryshme të botës që ishin pjesë e strukturës të sigurisë së Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ); numri i të vrarëve dhe të plagosurve etj., janë trajtuar në *Kapitullin e tretë*.

Kapitulli e katërt, ndërkaq, shënjon gjithë veprimtarinë luftarake të ZOSH, duke filluar nga 3 janari e deri më 17 qershor 1999; shënjon qëndresën dhe heroizmin e luftëtarëve të ZOSH, por edhe krimet dhe masakrat mizore të forcave serbe gjatë kësaj periudhe.

Strategjia që ka ndjekur UÇK, përparësitë dhe dobësitë e saj përballë forcave pushtuese dhe përparësitë dhe dobësitë e forcave serbe përballë UÇK-së; stërvitjet, armatimi dhe linjat e furnizimit me armë, roli i gruas në Luftën e UÇK-së në ZOSH, bashkëpunimi me popullatën civile dhe me subjekte të tjera vendore dhe ndërkombëtare etj., janë disa nga aspektet e trajtuara në kapitullin e pestë *Aspektet e strategjisë së UÇK-së*.

Kapitulli *Zona Operative e Shalës në shtypin e kohës 1998-1999*, që është kapitulli i gjashtë dhe i fundit, pasqyron veprimtarinë e kësaj Zone në shtypin shqiptar, serb, malazez, gjerman, britanik dhe amerikan. Disertacioni është shoqëruar me njësi e nënjësi të tjera të nevojshme dhe me aparaturë shkencore.

Materialet e siguruara gjatë hulumtimeve në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në Prishtinë, në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, në Muzeun e Qytetit të Mitrovicës - Sektori i Historisë; publikimet e veçanta nga Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991; publikimet e Organizatës Human Rights Watch, të Fondit për të Drejtën Humanitare, të Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut etj., përbëjnë një lëndë të veçantë që i ka dhënë formatin e nevojshëm këtij punimi.

Duke u mbështetur në këto burime, duke shfrytëzuar metodat deskriptive (përshkruese), komparative (krahasuese), analitike etj., thjesht metodologji përkatëse shkencore, duke lënë mënjanë modestinë, konsideroj se ky Disertacion përbën një kontribut të veçantë për historiografinë shqiptare lidhur me Luftën në Kosovë, posaçërisht për UÇK-në dhe njësinë e saj vartëse Zonën Operative të Shalës (ZOSH).

Pa kontributin dhe veprimtarinë e pjesëtarëve të kësaj Zone operative nuk mund të shkruhet e plotë as historia e UÇK-së dhe as Kosovës.

SUMMARY

The Shala Operational Zone (SHOZ) was one of the seven operational areas of the Kosovo Liberation Army (KLA). It was located in the territory of four different municipalities: Mitrovica, Vushtrri, Leposavic and Zubin Potok. It was bordered by the Drenica Operational Zone and the Llap Operational Zone. It consisted of the 141st Brigade "Mehë Uka", the 142nd Brigade and other subordinate units. Its commander was Rrahman Rama. Its military operations began in June 1998 and lasted until June 1999. The fiercest fighting in this area took place mainly in the suburbs and villages of the municipalities of Mitrovica and Vushtrri.

The doctoral dissertation entitled "**Combat activity in the Operational Zone of Shala 1998-1999**" focuses on the extension in time and space of combat activity that had taken place in this operational area. The dissertation is structured in six chapters: *I. The Kosovo Liberation Army and the circumstances of its creation; II. The Shala Operational Zone and its structure; III. Combat activity of the Shala Operational Subzone 1998; IV. Combat activity of the Shala Operational Zone 1999; V. Aspects of the KLA strategy; and VI. Shala Operational Zone in the press of the time, during the years 1998-1999.*

In the *First Chapter* the treatment of the main topic actually begins. Time and circumstances of the establishment of the KLA, its role in the process of the liberation of the country, confrontations with the forces of the Yugoslav Army (YA), the Ministry of Internal Affairs (MIA) and other security forces of the Federal Republic of Yugoslavia (FRY), constitute the pillars of this chapter. Of course, efforts to structure and restructure the KLA, including the Shala Operational Subzone (SHOSZ) during 1998, have not been neglected also.

The emphasis in the *Second Chapter* is mainly on the transformation of the Shala Operational Subzone (SHOSZ) into the Shala Operational Zone (SHOZ), its structuring and restructuring; scope, logistics, health care, communication and other issues related to the organizational structure and its functioning from November 1998 to June 1999.

Rapid combat actions, bloody battles and fierce fighting of the SHOSZ in the period June-December 1998 against the elite units of the Yugoslav Army, the police units of the Ministry of Internal Affairs, but also against foreign mercenaries from around the world who were part of the

security structure of the Federal Republic of Yugoslavia (FRY); the number of killed and wounded, etc., are dealt with in the *Third Chapter*.

The *Fourth Chapter*, meanwhile, examines all SHOZ combat activity, from January 3 to June 17, 1999; describing the resistance and heroism of the SHOZ fighters, but also the crimes and cruel massacres committed by Serbian forces against the unarmed Albanian population during this period.

The strategy pursued by the KLA, its strengths and weaknesses vis-a-vis the occupying forces and the strengths and weaknesses of the Serbian forces vis-a-vis the KLA; exercises, armament and weapons supply lines, the role of women in the KLA War in SHOZ, cooperation with the civilian population and other local and international entities, etc., are some of the aspects addressed in *Chapter Five*, entitled *Aspects of Strategy of the KLA*.

The chapter entitled *Operational Zone of Shala* in the press of 1998-1999, which is the sixth and last chapter, focuses on the activity of this Zone, according to its coverage in the Albanian, Serbian, Montenegrin, German, British and American press. This dissertation is accompanied by other necessary units and subunits and scientific equipment.

Materials collected during research in the National and University Library in Prishtina, in the National Library in Tirana, in the Archive of the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Albania, in the Museum of the City of Mitrovica - History Sector; special publications by the International Tribunal for the Prosecution of Persons Responsible for Serious Violations of International Humanitarian Law Committed in the Territory of the Former Yugoslavia since 1991; the publications of the Human Rights Watch Organization, the Humanitarian Law Center, the Council for the Protection of Freedoms and Human Rights, etc., constitute a special subject that gives the necessary format to this paper.

Relying on these sources, using descriptive, comparative, analytical methods, etc., simply relevant scientific methodologies; apart from any unnecessary modesty, I consider that this Dissertation constitutes a special contribution to the Albanian historiography related to the Kosovo War, especially concerning the war of the KLA and its subordinate unit, the Shala Operational Zone (SHOZ).